



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA ZYRA E
AUDITORIT TË PERGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit: 22.01-2009-08

**RAPORTI FINAL I AUDITIMIT TË PASQYRAVE
FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS
PËR FUNDVITIN 31 DHJETOR 2009**

Prishtinë, Qershor 2010

Tabela e përmbajtjes

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit
- IV. Qasja e auditimit
- V. Opinioni i auditimit
- VI. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e Komunës së Prishtinës dhe konkluzionet e ZAP-it

Lista e shkurtesave

AK	Autoriteti Kontraktues
AP	Auditori i Përgjithshëm
BKK	Buxheti I konsoliduar I Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës.
APP	Agjensioni për Prokurim Publik
DUKMM	Departamenti i Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedis
DUD-I	Dokumenti Unik Doganor
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
LVTH	Llogaria e vetme e thesarit
LMFPP	Ligji Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji Për Prokurimin Publik në Kosovë
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NPK	Ndërmarrja Publike Komunale
OE	Operatori Ekonomik
PF	Pasqyrat Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
UA	Udhëzimi Administrativ
UNIREF	Standardi i Unifikuar për Numra Referent për Grumbullimin e të Hyrave.
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prishtinës (Komuna) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Ne dëshirojmë të ju tërheqim vëmendjen në faktin se :

- Të ardhurat vetjake të cilat janë bartur nuk janë shpalosur si duhet;
- Pronat, objektet dhe paisjet nuk janë shpalosur dhe
- Detyrimet e papaguara nuk janë prezentuar

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës deri më 31 dhjetor 2009 *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, pozitive financiare (**ISSAI 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të çështjes**).

Auditimi jonë i pasqyrave financiare, transaksioneve financiare dhe menaxhimit financiar ka identifikuar dobësi në disa fusha kryesore, të cilat duhet të adresohen urgjentisht nga menaxhmenti në mënyrë që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i organizatës.

Rastet e ndryshme të kontrollit të dobët të brendshëm në të gjithë organizatën që janë theksuar në pjesën VII, shpijnë në konkludimin se niveli i kontrollit financiar, është joadekuat dhe duhet medoemos të përmirësohet.

Dobësitë e identifikuara në kuadër të këtij raporti kemi arritur një konkluzion të përgjithshëm se nevojiten përpjekje të mëtutjeshme, përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe kontrollit brenda komunës së Prishtinës.

Një program rivitalizues duhet të organizohet posaçërisht për të adresuar forcimin në:

- Raportimin e jashtëm;
- Raportimin e brendshëm;
- Delegim i qartë dhe transparent dhe ndarje e detyrave;
- Përcjellje menaxheriale dhe
- Auditim të brendshëm funksional

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Në këtë raport janë bërë më pas një numër ndryshimesh .

Çështjet e papërfunduar , për të cilat në si auditorë dhe entiteti i auditorë ende kemi pikëpamje te ndryshme , mund ti gjeni ne shtojcën 2.

Menaxhmenti është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë së Institucioneve Publike të Kosovës.

Është përgjegjësi e Komunës së Prishtinës të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 20/2009, dhe ato t’i prezantoj me kohë.

III. Objektivi dhe Fushëveprimi i auditimit

Auditimi i Komunës së Prishtinës ka të bëj me pasqyrat financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2009.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

IV. Qasja e auditimit

Qasja jonë e auditimit është zhvilluar gjatë këtij viti. Kemi adoptuar manualin e ri për auditimin tonë të rregullsisë që është më konform standardeve të auditimit të njohura ndërkombëtarisht. Ne kemi analizuar qasjen tonë të auditimit sipas katër fushave kryesore, si vijon:

- Të kuptuarit e Entitetit – të kuptojmë plotësisht entitetin, përfshirë këtu edhe kornizën e autoriteteve dhe të sistemeve kyçe, në mënyrë që të kuptojmë çështjet kyçe të cilat mund të kenë ndikim në pasqyrat financiare;
- Identifikimi i Rrezikut: duke kuptuar Entitetin dhe nga rezultatet e mëhershme të auditimit, ne identifikojmë rreziqet të cilat mund të shpijnë në keq deklarim material në pasqyra financiare ose mospërputhshmëri me ligjin;
- Kontrollat e Brendshme të Menaxhimit: aty ku identifikohen rreziqet, në kërkojmë të identifikojmë menaxhimin dhe kontrollat monitoruese të cilat mund të zvogëlojnë ato rreziqe; dhe
- Përdorimi i Procedurave Substanciale dhe Analitike – për të ofruar një siguri të auditimit me vëmendje të veçantë tek fushat ku dobësitë në kontrolle janë identifikuar.

Ne duhet kuptuar kontrollat e brendshme mjaftueshëm për të vlerësuar rrezikun e keq deklarimit material. Në përputhje me këtë kërkesë dhe punës sonë sipas kontrolleve të brendshme të menaxhimit të theksuara më lart, në dokumentojmë kontrollat e menaxhimit dhe ato monitoruese që të na ndihmojnë në informimin e gjykitimit tonë për rreziqet e keq deklarimit material.

Ne planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të qenë në gjendje të ofrojmë siguri të arsyeshme. Ne aplikojmë materialitetin për të na ndihmuar në planifikimin e auditimit tonë dhe vlerësimin e të gjeturave tona të auditimit. Në terme të përgjithshme, (siç specifikohet në standardet e auditimit) ne konsiderojmë që një çështje është materiale nëse mos shpalosja, keq deklarimi, përfshirja ose lënie jashtë e saj, me gjasë do të mund të ndërronte pikëpamjen e përgjithshme të dhënë nga pasqyrat financiare tek shfrytëzuesit.

Sipas qasjes sonë të rishikuar të auditimit, ne ndërmorëm një auditim të parakohshëm përgjatë këtij viti. Auditimi i parakohshëm duhet të kuptohet si një auditim që fillon nga viti fiskal që është nën auditim me qëllim të dhënies së rekomandimeve mbi atë se si:

- mund të trajtohen rekomandimet e mëparshme;
- të adresohen Pasqyrat Vjetore Financiare; dhe
- të adresohen çështjet e menaxhimit financiar gjatë vitit aktual.

Këtë vit ne kemi raportuar konkluzionet dhe rekomandimet tona nga auditimet e parakohshme në Memorandumet e Auditimit, në Janar të vitit 2010.

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2009;

2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
3. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të 1% si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare ;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
7. Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë.

Në këtë raport në përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2009.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet. Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1.

V. Opinioni i auditimit

Ne dëshirojmë të ju tërheqim vëmendjen në faktin se :

- Te ardhurat vetjake te bartura nuk jane shpalosur si duhet;
- Pronat, objektet dhe paisjet nuk jane shpalosur dhe
- Detyrimet e papaguara nuk jane prezentuar

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës deri më 31 dhjetor 2009 *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, poziten financiare (**ISSAI 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të çështjes**).

Testimi substancial ka shpalosur gabime dhe mos përfshirje të te hyrave vetjake në pasqyra financiare, Ne kemi vërejtur mos pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret, që po ashtu kanë ndikim negativ në saktësinë dhe plotësinë e pasqyrave financiare. Së fundi, Komuna nuk i ka përgatitur pasqyrat e saj financiare në pajtim me kërkesat e SNKSP-ve.

VI . Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2008 kishte dhënë 24 rekomandime.

Gjatë auditimit tonë të tanishëm ne kemi vërejtur se pesë (5) rekomandime janë implementuar pjesërisht ndërsa të tjerat mbeten ende të pa adresuara.

Fushat më të rëndësishme të cilat duhet ende të adresohen janë:

- Forcimin e kontrollit rreth menaxhimit të të hyrave nga prona publike;
- Regjistrimin e pasurisë jo financiare, siç kërkohet me UA Nr.21/2009;
- Zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me ligjet e aplikueshme;
- Regjistrimin e plotë dhe të saktë të obligimeve financiare dhe raportimin e tyre në Pasqyrat Vjetore Financiare;dhe
- Harmonizime mujore në mes të dhënave të Drejtorive, regjistrave të Bankës dhe Librit Kryesor(Departamentit të Thesarit).

Dështimi për të trajtuar plotësisht rekomandimet tona ka çuar në probleme të ngjashme si në vitet e mëparshme. Ku çështjet konsiderohen ende të rëndësishme që janë përsëritur në seksionet më poshtë. Mungesa e masave të vendosura mbi të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit janë një shqetësim.

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

VII.1 Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Tabela 1: Vështrim mbi buxhetet dhe shpenzimet për vitet 2009

Financimi/Shpenzimet	Buxheti 2009			Pagesat	Pagesat	Pagesat
	Fillestar	Rishikuar	Final	2009	2008	2007
Granti qeveritar dhe Ndihma	28,516,330	29,302,523	29,302,523	29,151,363	21,618,200	17,657,811
Te Hyrat Vetjake	14,000,000	14,000,000	26,722,246	18,460,430	12,805,189	9,773,171
Totali	42,516,330	43,302,523	56,024,769	47,611,793	34,423,389	27,430,982
Paga dhe Mëditje	14,377,325	14,974,515	15,236,112	15,132,076	13,058,540	11,945,022
Mallra dhe Shërbime	4,254,969	4,284,969	6,671,775	5,100,108	4,133,874	4,167,394
Shërbimet Komunale	2,694,871	2,703,872	2,703,116	2,703,116	1,432,304	1,435,306
Subvencionet dhe Transferet	540,000	540,000	589,369	578,052	490,900	510,784
Investime Kapitale	20,649,165	20,799,167	30,823,641	24,098,441	15,307,771	9,372,476
Totali	42,516,330	43,302,523	56,024,769	47,611,793	34,423,389	27,430,982

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM – Rr. Gazmend Zajmi nr. 59, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 (0)38 2535 217 – FAX: +381 (0)38 2535 219

Sipas të dhënave në tabelën e mësipërme Buxheti Final për Komunën e Prishtinës në vitin 2009 ishte 56,024,769 €. Burim financimi granti qeveritar 29,302,523 € dhe të hyrat vetjake 26,722,246 €. Sipas Pasqyrave Financiare në vitin 2009 nga donacionet e brendshme dhe të jashtme janë shpenzuar gjithsej 90,981 € për mallra dhe shërbime 46,419 € dhe për investime kapitale 44,562 €

Siç shihet në tabelën e mësipërme Komuna 99% të buxhetit e ka shpenzuar për Paga dhe Mëditje, për Mallra dhe Shërbime 76%, për shërbime komunale 99.97%, subvencione dhe transfere 98%, dhe Investime Kapitale 78% nga buxheti i ndarë për këtë kategori. Si rezultat I kësaj analize rrjedhë se Komuna e Prishtinës për çdo kategori ka pasur rritje të theksuar të buxhetit në krahasim me dy vitet paraprake.

Konkluzion

Komuna nuk ka shpenzuar buxhetin e përgjithshëm për vitin 2009 sipas parashikimeve. Shkalla e ekzekutimit buxhetor është 85%. Rreth 8,5 milionë të pa shpenzuara janë domethënëse.

VII.2 Pasqyrat Financiare

2.1 Cilësia e informatave

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit dhe për këtë ne po u raportojmë ato në pajtim me ISSAI 1260:

Udhëzimi Administrativ 20/2009 për raportimin vjetor të çdo organizate buxhetore neni 9 pika 3 kërkon që shuma e paraqitur si pranim është shuma aktuale e pagesave përmes LLVTH dhe paraqet burimin e fondeve të shpenzuara.

- Sipas analizave dhe rishikimit të pasqyrave financiare kemi vërejtur se shuma e pranimeve dhe pagesave në të gatshme nuk është bërë sipas shumave aktuale të pagesave siç është paraqitur në vijim :

	<u>BKK</u>	<u>THV</u>	<u>Pagesat nga pala e tretë</u>
Pranimet	29,302,523 €	26,722,246 €	141,204 €
Pagesat	29,154,057 €	18,377,111 €	90,982 €

- Në nenin 13 të pasqyrave financiare obligimet e papaguara nuk janë prezantuar në këtë tabelë por veçmas nga kjo;
- Në nenin 17 nuk janë paraqit ndarjet buxhetore me të gjitha ndryshimet e bëra gjatë vitit dhe mungojnë informatat plotësuese të detajuara lidhur me ekzekutimin e buxhetit;

- Në shënimin 27 të pasqyrave financiare, Komuna nuk ka shpalosur ndonjë shumë për pronat, objektet dhe pajisjet;
- Në shënimin 28 të hyrat vetjake të bartura nuk janë shpalos drejtë; Një diferencë e pashpjeguar prej 673 € është si bartje e të hyrave vetjake nga viti 2008, dhe në PF të vitit 2009, tregohet më e lartë.

Konkluzion

Pasqyrat Financiare nuk i kanë shpalosur të dhënat financiare që në aspektin material i bëjnë informatat e dhëna të mos jenë të besueshme.

Mangësitë në kontrollet e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj reziqeve dhe gabimeve.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të UA nr. 20/2009 dhe janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) “Raportimi Financiar, në Bazë të Kontabilitetit të Parasë se Gatshme”.

2.2 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

1. Komuna nuk ka arritur ti dorëzojë PF mbi Raportimin Vjetor në pajtueshmëri të plotë me UA nr. 20/2009;
2. PF janë nënshkruar me 10 shkurt 2010 nga Zyrtari kryesor administrative dhe zyrtari kryesor financiar;
3. PF janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
4. PF janë dorëzuar në MEF/Thesar me datën 10 shkurt 2010;
5. PF janë përgatitur vetëm në Gjuhen Shqipe;
6. Nuk janë dorëzuar raporte financiare tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2009.

VII.3 Realizimi i Buxhetit

3.1 Menaxhimi i të hyrave

Të hyrat e mbledhura për vitin 2009 sipas Thesarit ishin 17,299,944 €. Këto të hyra janë mbledhur kryesisht nga leje ndërtimi, tatimi në pronë, të hyra nga taksa administrative, të hyrat nga participimi në arsim-shëndetësi si dhe të hyrat tjera.

Në vijim do ti prezantojmë gjetjet për disa mostra të marra për testim nga kategoria e të hyrave. Përveç tatimit mbi pronën, dhe të hyrave nga licencat për biznese, Komuna nuk mban regjistra ose lista për të gjithë borxhlinjtë e saj në lidhje me taksat e ndryshme.

Buxhetet e përgatitura pa një bazë të qartë të financimit, mund ti shmangen përmbushjes së objektivave.

3.1.1 Të hyrat nga parku i Gërmisë edhe në vitin 2009 nuk ishin depozituar në llogari të Thesarit

Gjatë vitit 2009, Komuna nuk ka arritur që të implementoj rekomandimin që të hyrat nga parku i Gërmisë të depozitohen në llogarinë bankare të Komunës.

3.1.2 Të hyrat nga lejet e ndërtimit

Tek kjo kategori e të hyrave kemi gjetur:

(a) Sipas raportit vjetor të departamentit të urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit, hyrat nga lejet e ndërtimit për vitin 2009 ishin 8,756,842 €. Ndërsa sipas evidencës në drejtorinë e financave 8,763,792 € Diferenca prej 9,517€ ka rezultuar nga pamundësia e harmonizimit të dhënave me dokumente burimore. Inkasimet në shumë raste janë bërë pa UNIREF në bazë të Aktvendimeve, gjë që kanë vështirësuar harmonizimin e të hyrave;

(b) Nga 38 zëra të testuar në regjistrin e financave të DUKMM-së janë gjetur tetë gabime; prej tyre gjashtë nënvlerësime në shumë prej 52,096 € dhe dy mbivlerësime në shumë prej 9,130 € .

(c) Nga dhjetë 10 mostra të testuara, në gjashtë raste kemi gjetur se ka skaduar afati për inkasimin e të hyrave që i takojnë vitit 2009. Shuma e cila do të duhej të inkasohet nga këto gjashtë Aktvendime ka qenë 4,101,008 €, kurse janë inkasuar 2,631,283 €. Diferenca prej 1,469,725 € ose 35% nuk është inkasuar në kohën e paraparë me Aktvendim.

3.1.3 Të hyrat nga Licencat për Biznes

Në kuadër të drejtorisë për ekonomi dhe financa konstatoam se shuma në faturat 00007, 00008 dhe 00009 për rentën në tokë ishte 33,917 €, kurse shuma e testuar 36,982€ që rezulton me një diferencë prej 3,064 €, në dëm të buxhetit të Komunës.

3.1.4 Të hyrat nga Tatimi në Pronë

Të hyrat nga tatimi në pronë janë realizuar në shumë prej 4,014,906 € dhe në krahasim me vitin 2008 një rënie prej 2%. Menaxhmenti duhet ti analizojë arsyet pse të ardhurat janë në ulje. Niveli i të ardhurave të taksave në pronë është shqetësuese.

Konkluzion

Mungesa e evidencave të sakta mbi të arkëtueshmet nga Parku, kontrollet jo të duhura dhe të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat dhe sistemin e faturimit rrisin rrezikun që të hyrat të keqpërdoren. Komuna nuk ka aplikuar mekanizma të duhur kontrolli mbi gjendjen e të hyrave. Në një situatë të tillë nuk është e mundur të bëhen barazimet mbi të hyrat sipas evidencave kontabël dhe sistemit të faturimit.

Rekomandimi 2

Për të përmirësuar rritjen e të hyrave, rekomandojmë Kryetarin e komunës që të sigurohet se:

- Menaxhimi i të hyrave vetjake bëhet në pajtim me LMFPP dhe të gjitha pagesat të depozitohen në Llogarinë e Vetme të Thesarit si dhe të ndalohet praktika e depozitimeve në llogarit tjera bankare;.dhe
- Të kryej barazime të rregullta midis dy sistemeve në periudha të rregullta për të gjitha llojet e të hyrave. Në rastet kur ka diferenca, ato duhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brenda afatit të caktuar.

3.2 Menaxhimi i Shpenzimeve

3.2.1 Pagat dhe Mëditjet

Në kuadër të shpenzimeve për paga dhe mëditje për delegat janë paguar shuma prej 281,029 € në të cilën shumë janë përfshirë edhe disa pagesa që janë dedikuar punëtorëve të administratës në formë të stimulimeve. Ne vitin 2008 në kuadër të mëditjeve për delegatë dhe komisioneve shuma e paguar ishte 64,526 €, ndërsa në vitin 2009 kjo shumë ishte rritur për më shumë se tri herë.

Ne kemi vërejtur se në kuadër të shpenzimeve për mëditje të këshilltarëve janë përfshirë edhe dy persona të cilët nuk kanë qenë këshilltarë komunal. Kuvendi i Prishtinës kishte 51 këshilltarë Komunal, ndërsa pagesa është bërë për 53 këshilltarë Komunal.

Konkluzion

Regjistrimi i shpenzimeve të ndryshme nuk e prezanton pasqyrën e drejt të shpenzimeve sipas kodeve përkatëse. Pagesa e personave të cilët nuk janë këshilltarë të Kuvendit paraqet një kontroll të dobët të menaxhmentit për ekzekutimin e pagesave.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Pagesat për të gjithë këshilltarët e Kuvendit është bërë sipas kërkesave që dalin nga UA 16/2008 për stafin politik si dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve përkatëse, ashtu siç parasheh plani kontabël i Thesarit. Rasti i pagesës jo ligjore për dy personat përkatës të hulumtohet dhe të merren masat e duhura.

3. 2.2 Mallrat dhe Shërbimet

Te kontrata për furnizim me material edukativ për institucionet parashkollore kemi vërejtur se është ofertuar në vlerë 93,386 €, pagesa është bërë në vlerë prej 93,618 €, përkatësisht 231 € më shumë. Specifikacioni i përgatitur për këtë tender është bërë duke përkthyer artikujt me emërtime të caktuara. Këta artikuj kishin të bëjnë për 47 lloje të lodrave për fëmijët e institucioneve parashkollore. Më qëllim që të vërtetohet dhe sigurojmë se malli është pranuar ashtu siç është kërkuar në ofertë, ne kemi ekzaminuar dy institucione parashkollore dhe në këtë rast kemi vërejtur se artikujt e pranuar nuk korrespondojnë me emrat e paraqitura në fletë-dërgesën e furnizuesit.

3.2.2.1 Oferta e kualifikuar me çmim më të ulët nuk është përzgjedhur

Te kontrata për furnizim me material didaktik në vlerë prej 55,376 €, ishte eliminuar operatori tjetër me çmimin e ofruar prej 48,368 €. Ky operator ekonomik është eliminuar me arsyetim se ka bërë korrigjim në ofertën financiare. Me qëllim të verifikimit të pohimeve të prokurimit për këtë rast është kërkuar që të bëhet hapja e kopjes së ofertuesit për të cilën kërkesë kemi marrë përgjigje me shkrim se kopja nuk ruhet dhe është refuzuar kërkesa jonë. Sipas dosjes së tenderit pika 4.4 (i) të gjitha fletët e tenderit duhet të lidhen dhe të numerizohen. (ii) të gjithë tenderët duhet të dorëzohen në një kopje origjinale të vendosur në një zarf të veçantë të shënuar "ORIGJINAL" dhe një kopje të nënshkruara në të njëjtën mënyrë sikur origjinali dhe të vendosura në një zarf të veçantë të shënuar KOPJE.

3.2.2.2 Pranimi i mallit jo sipas specifikacionit teknik

Te projekti furnizim me inventar për objektin e ri komunal janë pranuar inventar në vlerë prej 382,239 € deri sa kontrata është në vlerë prej 378,167 € dhe pagesa e inventarit është paguar sipas vlerës së kontratës. Është gjetur se janë pranuar 8 karrige në vlerë prej 8,141 € të cilat nuk kanë qenë në ofertën e ofruar.

Po ashtu e nuk janë pranuar artikuj sipas ofertës; në pikën 16 kurriz për bartjen e kabllave nga dyshemeja deri në tavolinë 186 copë në vlerë 4,070 € janë ndërruar me 4 karrige. Sipas ekzaminimit fizik me datën 10 mars 2010 nga ekipi i auditimit dhe anëtarët e komisionit të cilët kanë pranuar mallin, kemi vërejtur se prej 8 karrigeve të pranuar në vend ndodhje ishin vetëm 6 sosh.

Konkluzion

Mos funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në nivelin e duhur ka rezultuar në ekzekutimin e pagesave pa u pranuar artikujt e kontraktuar, të cilët nuk korrespondojnë me nomenklaturën e paraqitur në fletë-dërgesën e furnizuesit.

Po ashtu, në rastin e dytë, ndërrimi i llojeve të materialeve ka ndikuar në dëmtimin e buxhetit të Komunës. Në përgjithësi, kontrollet e brendshme vlerësohen të dobëta për t'i ofruar siguri menaxhmentit se proceset e prokurimit dhe pagesave janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj se:

- Të forcohen kontrollet lidhur me punën e komisioneve të vlerësimit dhe zhvillimit të proceseve të prokurimit në përgjithësi; dhe me kontrata të shpërblehen operatorët më konkurrent dhe më të favorshëm;
- Aplikimi rigoroz i kushteve të përcaktuara me kontratë dhe në specifikacionin teknik, siç ishte rasti me aprovimin e ndërrimit të materialit;
- Menaxhmenti i Komunës duhet të hetoj rastet e ndodhura dhe të merr masat përkatëse për mungesën e konstatuar.

3.3 Investimet Kapitale

3.3.1 Furnizim me katër automjete për brigadën e zjarrfikësve

Sipas rishikimit të kësaj lëndë kemi vërejtur se para nënshkrimit të kontratës, në dosje nuk është gjetur sigurimi i ekzekutimit në shumë prej 10% nga vlera e kontratës . Gjithashtu, nuk kemi gjetur dokumentin i cili dëshmon se fituesi ka ofruar garancionin për servisim të autorizuar.

Kontrata është e nënshkruar me datën 31/07/2009 nga Komuna dhe me datën 03/08/2009 nga Operatori Ekonomik. Pranimi i automjetit është bërë në gjendje të rregullt sipas komisionit për pranim me datën 07.09.2009 , ndërsa pagesa është bërë me 11.09.2009 në vlerë prej 298,440 €.

Me kërkesën e Njësitit të zjarrfikësve për të evituar defektin e vërejtur nga punëtorët zjarrfikës është marrë për servisim automjeti nga OE me datën 07.10.2009 dhe data e kthimit nga kompania në njësitin e zjarrfikësve është 24.12.2009.

Ne vizituam Njësitin e zjarrfikësve në bashkëpunim me Auditorët e brendshëm të Doganave të Kosovës dhe ekspertët Doganor për të vërtetuar automjetin se a i përgjigjet përshkrimit sipas DUD-it. Sipas këtij dokumenti të datës 13.06. 2010 ky automjet ishte i vlerësuar në vlerë prej 11,000 €.

Automjeti ekzistues në Njësitin e zjarrfikësve është një automjet i zjarrfikësve për shpëtimin e qytetarëve me shkallë 30 metra, ndërsa fatura blerëse e këtij automjeti si dhe DUD-i i ofruar nga ana e Doganës dhe sipas librezës së regjistrimit të automjetit ky automjet figuron si automjet transportues.

Ne vlerësuam me ekspertët e doganës se ky automjet ekzistues vetëm numrin e shasisë e ka të njëjtë me dokumentacionet zyrtare.

Çmimi i paguar është 27 here më i lartë sesa është vlerësuar nga Dogana.

Ne nuk kemi mundur të gjejmë arsyetim se si komisioni i vlerësimit ka arritur në këtë shumë të kontratës së dhënë.

3.3.2 Ndërtimi i unazës qendrore (zona perëndimore), faza e II-të

Në dosje të tenderit është gjetur sigurimi i ekzekutimit i cili kishte të bënte për një tender tjetër jo për projektin ndërtimi i unazës qendrore.

3.3.3 Rregullimi i rrugës dhe trotuarit nga kompania ABC

Një gabim i gjetur në specifikacionin teknik nga AK ka rezultuar që të ndryshoj edhe vlerat e të gjithë ofertuesve. Ky gabim kap vlerën mbi 17,000 € për fituesin.

Kushtet e veçanta të kontratës nuk janë në përputhshmëri me kontratën e lidhur sepse pagesat në kontratë janë paraparë të bëhen 1/3 nga vlera e kontratës për punët e kryera e jo 1/2 siç parashihej në kushtet e veçanta. Po ashtu, sigurimi i ekzekutimit i ofruar nga operatori ekonomik nuk i përgjigjet kushteve të kontratës. Sigurimi i ekzekutimit është kërkuar për 12 muaj, ndërsa ishte ofruar vetëm për 2 muaj.

3.3.4 Ndërtimi i rrugës Ballaban - Keqekollë

Organi mbikëqyrës i projektit ka marrë pjesë edhe në komision për vlerësim edhe në mbikëqyrjen e punimeve; Ky mund të jetë konflikt interesi.

3.3.5 Ndërtimi i rreth rrotullimit në lagjen “Arbëria”

Raporti i organit mbikëqyrës të projektit ndërtimi i rrethrotullimit përmban gabime dhe mos përputhje në mes numrit të identifikimit të konstatuar në raportin e tyre dhe numrit të identifikimit të kontratës. Gabim tjetër është vërejtur në konstatimin se punimet kanë filluar më datën 08/10/2007 ndonëse kontrata është lidhur me datën 21/04/2009 si dhe nuk janë dhënë përshkrime për punët e kryera. Raporti për praninë të punëve nuk i përket projektit ndërtimi i rrethrotullimit, por të një projekti tjetër.

Po ashtu, janë zhvilluar procedura të prokurimit për furnizim me gypa në vlerë prej 46,300 €, ndonëse kjo ka mundur të planifikohet dhe të përfshihet në projektin paraprak që është lidhur për ndërtimin e udhëkryqit në Arbëri.

Konkluzion

Gjetjet e identifikuara më lart janë rezultat i kontrolleve të dobëta nga menaxhmenti.

Prokurimet e sipër përmendura të Komunës, kanë shkelur Rregulloret e prokurimit. Mangësitë e vërejtura në lidhje me kontrollet e brendshme për sa i takon prokurimeve, janë jashtëzakonisht serioze dhe në mënyrë të theksuar e rrisin rrezikun e prokurimeve të Komunës së Prishtinës ndaj mashtrimit, humbjes dhe keqpërdorimit.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Të zhvillojë politika dhe procedura për të garantuar që cilado kompani që do të marrë kontratën të ofrojë sigurimin e ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës;
- Rasti i Brigadës së zjarrfikësve të hetohet më në detale dhe ne baze të gjeturave të ndërrmiren hapa të mëtejme.
- Se me rastin e formimit të komisionit për vlerësim, të mos caktohen individë të njëjtë; edhe për vlerësim të ofertave edhe për mbikëqyrje te projektit;
- Të forcohet kontrolli mbi çertifikimin e pagesave për parandalimin e veprimeve që të mos lejojë ekzekutimin e asnjë pagesë pa u siguruar se punimet janë përfunduar;
- Të zbatojë politikat dhe procedurat adekuate për të garantuar që komuna i përmbahet të gjitha kërkesave administrative të prokurimit, siç është përgatitja dhe dorëzimi i planeve fillestare dhe finale të prokurimit; dhe
- Sigurojë që zyrtarët autorizuar për pranimin e mallrave verifikojnë specifikacionet sipas kontratave para pranimit të mallrave dhe duke e kompletuar dokumentacionin e kërkuar.

3.4 Subvencionet dhe Transferet

Tek dy kontratat njëra në vlerë prej 13,510 € dhe tjetra në vlerë prej 20,245 nuk i kemi vërejtur në dokumentet që na u janë ofruar, se përfituesit e ndihmës për furnizim me Sera dhe Farë janë nënshkruar dhe nuk kuptohet mënyra e përzgjedhjes së tyre.

Në një rast përkrahja për shpalljen e sportistit të vitit 2008 nuk kemi gjetur vendimin për aprovimin e kësaj pagese si subvencion. Vlera e përkrahjes ishte 7,970 €.

Në kuadër të subvencioneve kemi vërejtur pjesa më e madhe e shpenzimeve nga kategoria e subvencioneve janë paguar punëtorët e administratës së komunës në shumë prej 361,139 € apo 62% nga vlera totale e subvencioneve. Përdorimi i Kategorisë së Subvencioneve honorar të brendshëm nuk është edhe aq transparente. Nevojitet bazë e qartë juridike, që është ligji apo vendimi i qeverisë që në mënyrë të qartë e autorizon atë shpenzim.

Konkluzion

Mos shpallja e konkursit me kritere të caktuara dhe të qarta e rrit dyshimin në lidhje me furnizimin me Sera përfitues kanë qenë të favorizuar nga Komuna. Gjithashtu përqindja e lartë e shpenzimeve si subvencione në dobi të punonjësve të administratës nuk është në harmoni me rregullat financiare. Për më tepër ne nuk mund të sigurohemi që paratë publike janë duke u menaxhuar në nivelin e duhur dhe funksional.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj se:

- Janë formuar komisione profesionale mbi vlerësimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të projekteve të financuara nga subvencionet;
- Komisionet duhet të bëjnë vlerësimin adekuat të të gjithë aplikuesve të këtyre projekteve dhe mos të shkelen parimet bazë të përcaktuara sipas kriterëve të parapara;
- Të ndërmirren masat e duhura për pagesat e bëra pa baza të qarta.

3.5 Menaxhimi i Prokurimit

Të gjeturat e raportuara në nën-kapitujt e mësipërm demonstrojnë se Komuna e Prishtinës ka ndërmarrë procedurat e prokurimit, të cilat nuk janë në pajtim me Rregulloren 2007/20.

Konkluzion

Komuna e Prishtinës ka kontrolle të brendshme joadekuate mbi procesin e saj të prokurimit duke e rritur kështu rrezikun e mashtrimit, humbjes ose keqpërdorimit. Ne kemi gjetur parregullsi të mëdha pothuajse tek çdo prokurim i rishikuar dhe jemi të shqetësuar me shkeljet e ligjit të prokurimit.

3.6 Menaxhimi i Pasurive

3.6.1 Pasuritë aktuale

Mos harmonizim në mes mjeteve në llogari bankare dhe librit kryesor

Në kuadër të Komunës ekziston vetëm llogaria kryesore bankare në BQK. Të hyrat në këtë llogari bankare janë prezantuar në shumë prej 17,137,159 €, ndërsa sipas Thesarit 17,299,944 €. Zyrtarët e Komunës nuk ishin në gjendje që të shpjegojnë mosbarazimin prej 162,785 € në mes llogarisë bankare dhe librit kryesor.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj :

- Se gjendja e të hyrave të depozituara në BQK duhet të barazohet me gjendjen e Thesarit. Diferenca më lartë e prezantuar duhet domosdoshmërisht të sqarohet.

3.6.2 Pasuritë Fikse

Mungesa e regjistrit gjithëpërfshirës të pasurive

Komuna gjatë vitit 2009 nuk kishte arritur të hartoj një regjistër gjithëpërfshirës dhe të qartë për pasurinë fikse. Përveç inventarizimit në fund të vitit, nuk kishte formuar një komision për vlerësimin e pasurive fikse, siç janë: toka, ndërtesat dhe rrugët.

Konkluzion

Mungesa e një regjistri gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve bën të pa mundur kontrollet e brendshme mbi pasuritë e komunës. Kjo mund të shpie deri në keqpërdorim të pasurive dhe në mos identifikimin e këtyre keqpërdorimeve në kohën e duhur.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:

- Të mbajë një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve;
- Të përfshijë burime shtesë në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës;
- Të bëjë inventarizimin e rregullt fizik për të siguruar ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.

3.7 Menaxhimi i detyrimeve kontingjente

Janë gjetur fatura të paguara në vitin 2009 të cilat nuk ishin prezantuar në pasqyrat financiare në vitin 2008. Një detyrim kontingjente në shumë prej 274,265 € ishte paguar nga komuna me një vendim gjyqësorë sipas të cilit vendim ishte dhënë urdhër që t'i paguhet një personi fizik si kompensim për paluejtshmërinë në shumë prej 272,000 €.

Konkluzion

Mungesa e politikave të përshtatshme mbi detyrimet, redukton aftësinë e menaxhmentit për kontroll dhe marrjen e vendimeve të drejta dhe efektive sa i përket kësaj. Për më tepër detyrimet kontingjente, komunën mund ta sjellin në vështirësi të pa pritura financiare.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë kryetarin e komunës që të siguroj se:

- Kontabilitetit disponon me të gjitha informatat për detyrimet e papaguara dhe këto detyrime janë të prezantuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare ashtu siç kërkon UA 20/2009 dhe
- Detyrimet e papaguara duhet të shpalosen, të vlerësohen dhe të buxhetohen për vitin vijues..

VII. 4 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Ne kemi identifikuar menaxhim dhe kontroll të dobët në fushat në vijim, siç është shfaqur në seksionet më lart.

- Mos përgatitja e Pasqyrave Financiare ne pajtueshmëri te plote me Udhëzimin Administrative No.20/2009;
- Shmangie e Rregulloreve dhe ligjit te prokurimit publik, ne lidhje me përzgjedhjen dhe nënshkrimin e kontratave per mallra, shërbime dhe investime kapitale.;
- Dështim në menaxhimin e subvencioneve;
- Dështimi për te qene ne përputhje me ligjin e Menaxhimit Financiar, ne lidhje me certifikimin e shpenzimeve te shkaktuara;dhe
- Sistem joadekuat i kontrollit për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive fikse.

Konkluzion

Shembujt e ndryshëm e kontroleve te dobëta të brendshme pergjate organizatës, qe jane përshkruar ne kapitullin e VII na bëjnë te konkludojme se kontrollet ne përgjithësi janë te dobëta dhe nuk ofrojnë siguri se aktivitetet e operacionale dhe menaxhimi financiar funksionojnë ne pajtim me objektivat e caktuara nga Komuna.

VII.5 Auditimi i Brendshëm

Në Komunën e Prishtinës ekziston NJAB i cili përbëhet prej një drejtori të auditimit dhe një auditor. Roli kryesor i Njësisë së Auditimit të brendshëm është ofrimi i sigurisë për menaxhmentin që sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon siç është synuar. NJAB kishte përgatitur një plan vjetor për vitin 2010 i cili është miratuar nga komiteti i auditimit me datën 13/02/2010. Në këtë plan të auditimit kishte për objektiv vlerësimin e procedurave të hyrave, shpenzimeve dhe vlerësimin e pasurive fikse në drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës. Periudha e audituar nga NJAB kishte të bëjë për vitin 2008. Në raportin e lëshuar për këtë auditim janë vërejtur shumë nga parregullsitë dhe janë dhënë rekomandime përkatëse. Megjithatë, komuna ende nuk ka bërë hapa të rëndësishëm për t'i zbatuar rekomandimet.

Konkluzion

Përkundër auditimit të kryer në Drejtorinë e arsimit dhe kulturës, menaxhmenti nuk mund të siguroj se sistemi i kontrollit të brendshëm është duke funksionuar në nivelin e kërkuar. Ne nuk kemi mundur të mbështetemi në rezultatet e auditimit të brendshëm gjatë planifikimit dhe ekzekutimit të auditimit tonë të jashtëm sepse auditimi i brendshëm ka kryer auditime për aktivitetet e përfunduara gjatë vitit 2008.

Në përgjithësi, auditimi i brendshëm nuk ka kryer funksionin e tij, pasi që nuk ka asnjë aktivitet për vitin aktual. Auditimi i brendshëm ka rol evitues dhe duhet të kuptohet si një auditim i cili kryhet në një kohë, ku akoma i lejohet auditimit të brendshëm të evitohet një veprim i cili gjykohej të jetë i parregullt.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Kryetarin e komunës që të siguroj :

- Se Auditimi i brendshëm ofron siguri në lidhje me kontrollet, duke e forcuar rolin e tij;
- Auditimi i brendshëm duhet të hartoj Plan pune për vitin aktual, t'i zbatohet ato si dhe të prioritetizoj fushat me rrezik të lartë;
- Auditimi i brendshëm t'i dorëzoj raporte të rregullta menaxhmentit, këshilla dhe rekomandime mbi mangësitë në implementimet e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

(a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);

(b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;

(c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;

(d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksim i çështjes. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

(a) ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit

Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo

(b) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM – Rr. Gazmend Zajmi nr. 59, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 (0)38 2535 217 – FAX: +381 (0)38 2535 219

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionin i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinionin që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionin i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinionin nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinionin jo i kualifikuar.

Shtojca 2

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti .Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar .Çështjet e papërfunduar , për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si me poshtë:

Komentet e Komunës së Prishtinës dhe konkluzionet e ZAP-it

Nr.	Referenca	Komentet e Komunës së Prishtinës	Konkluzionet finale të ZAP
1.	3.1.1 Menaxhimi i të hyrave	<p>a) Harmonizimi i të hyrave,</p> <p>b) Të hyrat nga parku i Gërmisë.</p> <p>Që nga fillimi i vitit 2010 është përpiluar tabela e barazimit të të hyrave në mes drejtorive dhe shërbimit të financave. Problemet që shfaqen më së shumti lidhen me mjetet e paguara në bankë, të cilat arkëtohen në llogari të ndonjë Komune apo institucioni tjetër. Kthimi i këtyre has në shumë vështërsi, sepse llogaria në BQK rritet ndërsa në sistemin Free Balance paraqitet si zvogëlim (shih provën). Raportet bankare-ekstrakti forma manuale tani e tej shkuar, (vështirësitë në procedimin e të dhënave).</p> <p>b) Është formuar komisioni për mbikëqyrjen e inkasimit të të hyrave nga parku "Gërmia".</p>	<p>Menaxhmenti i komunës pajtohet me dobësitë ekzistuese dhe ka filluar të ndërmarr veprime konkrete mbi korrigjimet e nevojshme. Në auditivin e radhës do të përcjellim shkallën e implementimit.</p> <p>Gjetjet e auditimit mbeten të pa ndryshuar.</p>
2.	3.2.2 Mallra dhe shërbime	<p>Tek kontrata furnizim me material edukativ, gjatë shumëzimit të numrave si pasojë e shkrimit të dobët të ofertuesit, tri pozicione janë lexuar gabimisht dhe oferta ka ndryshuar për 231 euro. nga vlera totale e kontratës prej 93,386 euro. Pajtohemi me konstatimin mbi këtë lëshim të identifikuar dhe kompania fituese do të kompensoj</p>	<p>Komuna është pajtuar me gjetjet e raportit. Zyrtarët përgjegjës të Komunës duhet të jenë palë aktive në zgjidhjen e kësaj çështje.</p>

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM – Rr. Gazmend Zajmi nr. 59, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 (0)38 2535 217 – FAX: +381 (0)38 2535 219

		<p>ndryshimin e çmimit.</p> <p>Sqarim: prokurimi nuk e menaxhon kontratën por "Njësia Kërkuese". Sipas deklarimeve të Njësise kërkuese - Çerdheve, tërë malli gjendet sipas sasisë dhe cilësisë së kërkuar, por gjatë vizitës së auditorit nuk kanë qenë stafi i ngarkuar për sqarime të nevojshme. (Prova nr.1.a.) Ne do të kërkonim nga Ju që të bëjmë regjistrim komplet të mallit të "kontestuar" për të nxjerrë gjendjen faktike.</p> <p>Qëndrojmë pranë konstatimit se kualifikimi i juaj është i paqëndrueshëm. Prova e ofruar tregon se malli është pranuar sipas specifikave të caktuara në kontratë.</p>	<p>Dy nga personat përgjegjës të njësise kërkuese - Çerdheve ishin prezent gjatë auditimit por nuk kanë mundur të na ofrojnë dëshmi se malli i pranuar është i cilësisë së njëjtë me atë të kërkuar në bazë të specifikacionit.</p> <p>Konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit mbeten të pa ndryshuara.</p>
3.	3.2.2 .1 Oferta e kualifikuar me çmim më të ulët nuk është përzgjedhur	<p>Është zgjedhur oferta më e lirë, sepse gjatë vlerësimit është konstatuar se një ofertë në hapje e lexuar si më e lirë ka pasur "gabim" në një pozicion i cili e ka ndryshuar vlerën e ofertës. (Prova nr. 2, faqe 7). Autoriteti Kontraktues e ka identifikuar këtë "gabim" prandaj, bazuar në Rregulloren 2007/20, nenin 57 është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Në ofertën e OE ku është bërë "gabimi" është edhe vula e OE si dëshmi e qartë për AK. Ju keni kërkuar provë të ju sjellim kopjen e ofertës para më shumë se një viti. Ju e citoni ligjin në pjesën mbi numerizimin e fletëve të tenderit, ndërsa ky është obligim i OE e jo i AK . Ju njoftojmë se sipas ligjit respektiv dosjen e tenderit, fq.14 (iii) thuhet se "një nga kopjet e dorëzuara duhet të mbahet e pa hapur nga ana e AK për OSHP-në, si provë në rast të ndonjë pretendimi për përmbajtjen e tenderit" (Prova nr.3). Ju e dini se këso pretendime mund të ketë deri 8 ditë pas njoftimit për fituesin e tenderit.</p>	<p>Bazuar në ankesën e OE se nuk e ka bërë përmirësimin dhe sqaron se të gjitha fletat e ofertës janë të vulosura, kemi vërtetuar se vula nuk gjendet vetëm te përmirësimi i çmimit por tek të gjitha fletat e ofruara.</p> <p>Ne nuk patëm mundësi të bindemi se ky ndryshim çmimi është bërë nga OE, pasi që nuk është hapur një zarf i veçantë të shënuar KOPJE.</p> <p>Mbetet e gjetura dhe rekomandimi i ZAP-it.</p>

4.	<p>3.3.1 Investimet kapitale</p> <p>Furnizim me automjete për brigadën e zjarrfikësve</p>	<p>Vërtetohet se gjendja faktike është si vijon: Nuk ka mangësi sa ju përket procedurave të prokurimit.</p> <p>Të gjitha kompanitë fituese kanë dorëzuar autorizimet për shitje dhe mirëmbajtje nga kompanitë e jashtme dhe kanë deklaruar në dokumentacionin e tyre se në afatin e garancionit 12 mujor në rast defekti apo ndonjë arsyeje tjetër servisimin e automjetit do ta bëjnë në një servis të autorizuar, edhe pse AK nuk ka kërkuar servis të autorizuar por vetëm servisim;</p> <p>Në Nenin 33 të Kontratës shkruan "Kontraktuesi obligohet që t'i përmbahet garancionit të ofruar për motor dhe pompë në një afat garantues prej 12 muajve në përputhje me kushtet e përgjithshme të "kontratës". I njëjti duke u bazuar në cilësinë e mallit, ka ofruar sigurimin e periudhës së mirëmbajtjes 18 muaj, që është 6 muaj më shumë se afati i kërkuar. Shiko polisa nr.09-12-08-07 Siguria vlen prej dt. 07.09.2009 deri më 07.03.2011. Sigurimi i periudhës së mirëmbajtjes për Automjetin special me shkallë është bërë në vlerën prej 29,844.00 euro (Prova nr.4)</p> <p>Sipas raporteve me shkrim, automjeti është pranuar në gjendje të rregullt (Prova nr. 5 dhe 6)</p> <p>Pas një muaj përdorimi, automjeti ka pasur nevojë për një servisim, i cili është kryer dhe na është raportuar se i njëjti automjet është në përdorim në Njësinë e zjarrfikësve. Ne kemi vizituar këtë njësi dhe si provë plotësuese se mjete është' në përdorim dhe në gjendje pune, po ju ofrojmë disa foto të dt.20.01.2010 (Provat nr.7- 4 faqe) dhe konstatimin e zyrtarit përgjegjës në Brigadën e zjarrfikësve se automjeti është pranuar pas servisimit dhe është në gjendje të rregullt</p>	<p>Përkundër arsyetimeve të shumta që ofrohen lidhur me blerjen e këtij automjeti, ne edhe më tutje mbesim në konkludimet tona se menaxhmenti i Komunës duhet të merret me vlerësimet më të hollësishme lidhur me këtë rast dhe të shihet se a është pranuar vlera për parane.</p> <p>Fakti se automjeti një muaj pasi është pranuar, është dërguar në servis ku ka qëndruar për më shumë se 2 muaj e gjysmë, është një indikacion se është pranuar një automjet me defekte të rënda teknike.</p> <p>Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 21/2009 mbi menaxhimin e pasurive qeveritare, norma e zhvlerësimit për automjete të rënda është 10 vite, çka rezulton se vlera e tij reale përputhet me vlerësimet e doganës në çmimin prej 11,000 €, e jo në çmimin prej 298,440 €, sa është paguar nga komuna.</p> <p>Gjetjet tona dhe konkluzionet në raport mbasin të pa ndryshuara, përkundër komenteve tuaja.</p>
----	---	---	--

		<p>(Prova nr.8).</p> <p>Njësia kërkuese, në këtë rast Drejtoria e Shërbimeve publike në përcaktimin e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve, ka marrë parasysh faktin se çmimi i një automjeti të ri të kësaj natyre kushton mbi 700,000.00 euro, prandaj duke pasur parasysh shumën që ka disponuar në buxhetin vjetor (rreth 600,000.00) është përcaktuar për furnizim me katër automjete të përdorura të cilat do të" plotësonin shumë më mirë dhe me efikasitet nevojat e qytetarëve të Komunës së Prishtinës (Prova nr.9)</p> <p>Në dosjen e tenderit, kushtet e dërgimit të mallit janë përcaktuar DDP (Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2000 Oda Ekonomike Ndërkombëtare) që është në përputhje me rastin tonë (Prova nr.10).</p> <p>Kjo për AK nënkupton se nuk janë relevante shpenzimet e OK, por vetëm oferta të cilën ai e bënë, e cila ofertë përfshin koston e mallit deri në vendin e pranimi (që është njësia e zjarrfikësve). Kështu që, konstatimi I juaj se çmimi I doganuar ka qenë i ulët, është jo relevant duke pasur parasysh kushtet e tenderit.Në konstatimin e komisionit të pranimi shihet se automjeti i kërkuar I plotëson kërkesat teknike dhe funksionale, sipas dosjes së tenderit dhe ofertës se kompanisë fituese (Prova nr.1 1).</p> <p>Mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të automjetit, kompania ka marrë Çertifikatë me nr. 793/09 ku është lejuar ndërrimi i destinimit të automjetit dhe ngjyra dhe është shndërruar në Automjet special - shkallë shpëtimi me 2 dyer. Në këtë çertifikate konfirmohet se automjeti është teknikisht në rregull</p>	
--	--	---	--

		<p>(Prova nr.12).</p> <p>Gjithashtu, Kompania për të njëjtin automjet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë (Universiteti i Prishtinës) ka marrë certifikatë nr. 1300/09 mbi atestimin e automjeteve dhe makinave punuese në transportin rrugor. Në këtë Çertifikatë ipet ky konstatim: Automjeti transportues është shndërruar në automjet special - shkallë shpëtimi. Njëherit është bërë ndërrimi i ngjyrës nga e kaltër në të kuqe. Ndërrimi i destinimit dhe ngjyrës është bërë sipas rregullave. Prandaj, për automjetin special me shënimet e cekura, jepet certifikata (Prova nr.13)</p> <p>Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës nuk është përgjegjëse për trajtimin e vlefshmërisë së dokumenteve të institucioneve shtetërore apo atyre të autorizuara (Fakulteti i Inxhinierisë, Qendra e regjistrimit të bizneseve, Dogana) lidhur me tarifat e pagesave apo ndryshimet teknike që bëhen në automjete, në pajtim me ligjin.</p> <p>Në intervistimin e Kompanisë fituese për këtë rast, kemi kuptuar se nga 2 automjete, ka përgatitur teknikisht automjetin e dorëzuar i cili në plotëni i plotëson kërkesat teknike. Po ashtu, i njëjti është në kooperim me Kompani tjera dhe për përgatitjen e këtij automjeti ka shfrytëzuar teknikë moderne të komandimit të automjetit dhe pajisjet tjera shtesë të parapara për automjet të zjarrfikësve.</p> <p>Ju me auditorin e brendshëm të doganës bëni krahasime vetëm për kamionin duke neglizhuar faktin bazik se automjeti është vërtet pjesa me e lirë konstruksionit të mjetit special "shkallë shpëtimi" dhe sistemit komandues automatik për ngritje të tyre në gjatësinë 30 metra për</p>	
--	--	---	--

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM – Rr. Gazmend Zajmi nr. 59, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 (0)38 2535 217 – FAX: +381 (0)38 2535 219

		<p>intervenime sipas destinimit të dhënë. Pra, ju keni vlerësuar vetëm një pjesë nga tërësia - vetëm trupin e mjetit transportues duke i eliminuar dhe pajisjet tjera përcjellëse (Prova 13a: katalogu i mjetit).</p> <p>Komisioni i vlerësimit, vlerësimin e bën sipas kritereve të dosjes së tenderit, vlerës së ofertave dhe çmimit aktual të tregut, të përafërt në kohën e vlerësimit. Po ju rikujtojmë se ka fituar oferta me e lirë dhe furnizimi është kërkuar sipas kushteve DDP.</p> <p>Nuk është kërkuar automjet transportues por automjet special-shkallë shpëtimi (lift) i zjarrfikësve dhe i tillë është pranuar dhe është në funksion. Në çdo rast mund të verifikohet se mjetet janë pranuar në pajtim me kushtet teknike dhe janë në funksion. Prandaj, kërkojmë që vërejtjet tuaja dhe rekomandimi të harmonizohen me gjendjen faktike, të cilën e kemi prezantuar në këtë pikë.</p>	
5.	3.3.2 Ndërtimi i unazës qendrore (zona perëndimore)	<p>Ka ndodhur një lëshim teknik në emërtimin e sigurimit edhe pse shuma është në përputhje me vlerën e tenderit e poashtu edhe afati. Edhe pse ky lloj sigurimi pasi e ka shumë mund të ekzekutohet pa asnjë vështirësi, ne pranojmë se do të angazhohemi që lëshime të tilla të mos përsëriten. Duhet theksuar se si pasojë e këtij lëshimi nuk ka rezultuar asnjë lloj dëmi. (Prova nr.14)</p>	<p>Menaxhmenti i Komunës së Prishtinës pajtohet me gjetjet e auditimit dhe zotohet se do të eliminohen rastet e tilla.</p> <p>Ne inkurajojmë menaxhmentin për veprimet që do të ndërmerren dhe në auditimin e radhës do të shohim nga afër progresin e arritur.</p> <p>Konkluzionet e auditimit mbesin.</p>
6.	3.3.3 Rregullimi i rrugës dhe trotuarit nga	<p>Vlerësimi është kryer në pajtim me Rregulloren 2007/ 20, nenin 57.</p> <p>Lidhur me kushtet e pagesës po japim këtë sqarim sepse ligji i</p>	<p>Sipas nenit 57 të LPP, AK duhet të përmirësoj gabimet në llogaritje nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve. Neni 57 I LPP nuk flet për</p>

	<p>kompania ABC</p>	<p>ka paraparë rastet kur mund të paraqiten ndryshime në dokumente. Në këtë rast, veprimi i AK ka qenë në përputhje me ligjin.</p> <p>Sipas nenin 3 të Kontratës: Radhitja e dokumenteve të kontratës sipas prioritetit është</p> <ul style="list-style-type: none"> - marrëveshja e kontratës - Kushtet e përgjithshme - Kushtet e veçanta - Tender i kontraktuesit dhe - Oferta financiare. <p>Dokumentet e ndryshme që e përbejnë kontratën konsiderohet se e shpjegojnë njëra tjetrën dhe në raste të paqartësisë ose shmangies, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilën janë dhënë më sipër. (Prova nr.15).</p> <p>Sa i përket vërejtjes lidhur me sigurimin e ofruar se nuk i përgjigjet kushteve të kontratës, vërejtja nuk qëndron sepse në kohën e kontrollimit të kësaj lënde, kontrata ka qenë në fazën e zbatimit dhe në pajtim me ligjin. Nga OE kemi siguruar Deklaratën e Garantuesit - sigurimi i Ekzekutimit të Tenderit për 60 ditë ndërsa sigurimi I përmbushjes për 12 muaj merret pas përfundimit të kontratës (Prova nr. 16).</p>	<p>përmirësimin e gabimeve të cilat mund të ndodhin në paramasën e përpiluar nga AK. Prandaj, AK duhet pasur kujdes që me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit, përkatësisht paramasës, të rishikohen dhe të korrigjohen me kohë gabimet në mënyrë që të mos sjellë paqartësi të ofertuesit.</p> <p>Komuna duhet të përcaktoj kushtet dhe metodat e pagesës dhe ato duhet t'i respektoj.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka arritur që të përfundoj punimet në periudhën prej 60 ditësh. Komuna duhet të përcjellë kushtet e kontratës dhe në rast të skadimit të sigurimit të ekzekutimit duhet të kërkoj ripërrirjen e sigurimit të ekzekutimit.</p> <p>Gjetjet dhe rekomandimet në raport mbesin të implementohen.</p>
7.	<p>3.3.4 Ndërtimi i rrugës Ballaban</p>	<p>Ky konstatim nuk është i bazuar në ligj, pasi ligji nuk e ndalon që i njëjti ekspert mund të jetë në vlerësim dhe në mbikëqyrje. Një ndalesë e tillë është e specifikuar në</p>	<p>Raporti ka për qëllim të evidentoj mungesat në sistemet e kontrolleve të brendshme dhe rreziqet që këto mungesa sjellin, dhe jo të listoj rregulloret dhe ligjet që</p>

	- Keqekollë	komisione tjera (në hapje dhe vlerësim të tenderëve)	ekzistojnë. Gjetjet dhe rekomandimet në raport nuk ndryshohen.
8.	3.3.5 Ndërtimi i rreth rrotullimit në lagjen "Arbëria",	Nuk është aktivitet i prokurimit. Në raportin e vet organi mbikëqyrës ka bërë gabime të natyrës teknike në përshkrimin e datave. Kjo është më se e qartë" dhe besojmë se lëshime të tilla nuk do të përsëriten. Sa i takon çështjes se" furnizimit me gypa në vlerë 46,300 euro, ky aktivitet është dashur të kryhet nga Ujësjiellësi "Prishtina" sepse është resurs i tyre por meqë ata kanë pasur probleme financiare, është dashur që këtë aktivitet ta kryej AK nga mjetet e veta me qëllim ta përfundoj ndërtimin e rrugës. Situata të tilla janë jashtë mundësisë së ndikimit të AK.	Menaxhmenti i komunës nuk konteston gjetjet e raportit, por ofron shpjegime se nën cilat rrethana kanë ndodhur. Ne presim zbatimin e rekomandimit lidhur me këtë çështje.
9.	3.4 Subvencionet dhe transferet	a) Pagesa e delegatëve është bërë konform UA 16/2008. b) Ndarja e subvencioneve për punëtorë të Komunës bazohet në vendimin e Kuvendit Komunal të datës 09/07/2009. Kjo pasi të ardhurat e punëtorëve në administratën e komunës janë jashtëzakonisht të ulta. c) Ndarja e subvencioneve për bujqësi është bërë në bazë të komisioneve nga bashkësitë lokale.	a) Zyrtarët përgjegjës në Komunë nuk kanë mundur të na ofrojnë dokument/dëshmi se pagesa e delegatëve është bërë konform UA 16/2008. Po ashtu, edhe me komente nuk na është ofruar një listë prej 53 anëtarëve këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës për të cilët është bërë pagesa. Në vend të kësaj është ofruar një listë e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës që kanë ndjekur mbledhjet gjatë vitit 2008. b) Lidhur me këtë pikë, Komuna nuk konteston gjetjen e auditimit, por vetëm shpjegon arsyen e ndodhjes. c) Zyrtarët përgjegjës në Komunë nuk kanë mundur të na ofrojnë një dokument si dëshmi ku kuptohet mënyra

			e përzgjedhjes së përfitueseve të këtyre subvencioneve. Gjetjet dhe rekomandimet në raport mbesin të pa ndryshuara.
10.	3.6.2 Pasuritë fikse	Komisioni i auditimit të brendshëm në bashkëpunim me njësinë e auditimit të brendshëm, kanë përpiluar procedura për regjistrim, inventarizim, vlerësim dhe menaxhim të pasurisë komunale. Kjo procedurë ka filluar të zbatohet dhe të përmbushet kërkesa për raportime financiare dhe rekomandimet e dhëna nga ZAP. Me qëllim të përmbushjes se kësaj procedure, është bërë sistematizimi adekuat i zyrtarëve në vendet e punës të cilët merren me menaxhimin e pasurisë në kuadër të komunës. Në fund të vitit 2009, komuna ka formuar komisionin për inventarizim të pasurisë komunale. Ky komision ka përgatitur raportin përkatës.	Menaxhmenti i komunës nuk konteston konkludimet nga raporti dhe shpjegon se veprime konkrete lidhur me gjetjet e auditimit tashmë kanë filluar të ndërmerren. Ne do të vlerësojmë progresin e arritur në një rast tjetër.
11.	3.7 Menaxhimi i detyrimeve kontingjente	Ekzistojnë detyrimet kontingjente për të cilat Komuna nuk posedon ndonjë të dhënë por vetëm njoftohet nga Departamenti i Thesarit për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Këto raste ekzekutohen kur procedura gjyqësore ka filluar vite më parë.	Menaxhmenti i komunës, përkatësisht Zyra ligjore, çdo fund vit duhet të bëjë vlerësimin e detyrimeve të mundshme dhe të njëjtat në bashkëpunim me departamentin e buxhetit të komunës t'i buxhetoj për vitin vijues. Po ashtu të njëjtat duhet të shpalosen në Pasqyra financiare.
12.	VII. 5 Auditimi i Brendshëm	Njësia e Auditimit të brendshëm ka përgatitur planin për 2010, i cili është aprovuar nga Komisioni i Auditimit të Brendshëm. Ky plan i auditimit ka të bëjë për vitin fiskal 2009 dhe 2010, e jo për 2008, siç ceket në raportin e auditimit të jashtëm.	Ne nuk kemi thënë se nuk ka plan të auditimit. Presim që rekomandimi lidhur me auditimin e brendshëm të zbatohet dhe kjo besojmë se do t'i ndihmojë vet menaxhmentit të Komunës.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM – Rr. Gazmend Zajmi nr. 59, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel.: +381 (0)38 2535 217 – FAX: +381 (0)38 2535 219